

L I G J
Nr.8139, datë 5.9.1996

**PËR DËRGIMIN E KOMPANISË PAQERUAJTËSE SHQIPTARE PËR TË MARRË PJESË
NË OPERACIONIN E NATO-S “PËRPJEKJA E PËRBASHKËT” NË ISH-JUGOSLLAVI**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të ligjit nr.7816, datë 20.4.1994 “Për ratifikimin e “Dokumentit Kuadër të Partneritetit për Paqe” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Kompania paqeruajtëse e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të dërgohet për të marrë pjesë në operacionin e NATO-s “Përpjekja e Përbashkët” në ish-Jugosllavi, në zbatim të marrëveshjes së Dejtonit.

Neni 2

Statusi i këtyre forcave do të jetë ai i përcaktuar në marrëveshjen SOFA, miratuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut lidhur me statusin e forcave”.

Neni 3

Ushtarakët që marrin pjesë në operacionin “Përpjekja e përbashkët”, për ditët e qëndrimit atje, veç pagës mujore, do të marrin për vështirësi shërbimi edhe një shpërblim ditor në masën që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ministria e Mbrojtjes të marrë të gjitha masat organizative e teknike për realizimin e detyrës nga kompania paqeruajtëse.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi më datën 5.9.1996.

Shpallur me dekretin nr.1596, datë 12.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha